

REZOLUTË

PËR VLERËSIMIN E PUNËS SË KOMISIONERIT PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI PËR VITIN 2013

Kuvendi i Shqipërisë:

- Duke konsideruar mbrojtjen e të drejtës së çdo personi për barazi para ligjit, parimin e barazisë dhe trajtimit për shanse dhe mundësi të barabarta, si dhe zbatimin e efektshëm të politikave antidiskriminim, si përparësi kyçe drejt progresit të shtetit shqiptar;
- Duke inkurajuar dhe mbështetur veprimtarinë e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, si një institucion i pavarur, i cili ka mision garantimin për mbrojtjen efektive nga diskriminimi dhe çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin, bazuar në një listë joshtruese arsyesh, të përcaktuara në dispozitat kushtetuese dhe ligjore;
- Duke shprehur bindjen e tij se progresi i veprimtarisë së Komisionerit në drejtim të luftës kundër diskriminimit është i mundur vetëm në sajë të një sistemi harmonizimi dhe koordinimi real të të gjitha strukturave në nivel qendror e vendor, medias, shoqërisë civile dhe publikut;

Vlerëson:

- Zhvillimin institucional në drejtim të zbatimit të ligjit për mbrojtjen nga diskriminimi dhe përpjekjet për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese për barazi dhe mosdiskriminim ndaj çdo individ.

Konstaton se:

- Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka materializuar punën e tij bazuar në legjislacionin në fuqi, objektivat që përcakton Planin Strategjik 2012-2015 dhe Planin i Veprimit për vitin 2013, si dhe zbatimin e rekomandimeve të Kuvendit për veprimtarinë e tij institucionale gjatë vitit 2013.
- Ka paraqitur, bazuar në raportet zyrtare të institucioneve shtetërore, organizatave jofitimprurëse dhe gjetjeve të rezultuara gjatë veprimtarisë së tij, një vështrim të tipologjisë dhe fenomenologjisë së çështjeve aktuale të diskriminimit.
- Ka synuar zgjerimin e veprimtarisë së tij në drejtim të njohjes institucionale në publik, nëpërmjet shtrirjes rajonale të fushatave gjithëpërfshirëse të ndërgjegjësimit dhe sensibilizimit, lidhur me mbrojtjen nga diskriminimi në Shqipëri.
- Megjithatë ka rritje të konsiderueshme të numrit të ankesave të depozituara gjatë vitit 2013, në raport me vitet e kaluara, ky trend mbetet larg pritshmërive që ky institucion ka në përmbushje të misionit të tij ligjor.
- Ka rritur veprimtarinë proaktive duke dyfishuar numrin e çështjeve *ex officio*.
- Ka një numër të ulët të aplikimit të masës administrative “gjobë”.

- Ka ofruar mbështetje të nismave të ndryshme legjislative, duke propozuar rekomandime ligjore në funksion të përmirësimit të legjislacionit në fuqi.

- Ka dhënë rekomandime të ndryshme drejtuar institucioneve përgjegjëse qendrore dhe vendore për përmirësimin e situatës për grupet vulnerabel, si dhe ka aplikuar ndërmjetësimin dhe mbështetjen ligjore të ankuesve me mbrojtje në proceset gjyqësore.

- Ka pasur mbështetjen dhe asistencën e vazhdueshme profesionale të organizmave ndërkombëtarë, që kanë objekt të veprimtarisë së tyre mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

Kuvendi kërkon nga KMD-ja për vitin 2014:

- Të fokusojë veprimtarinë institucionale në nxitjen e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit, në vëmendje edhe të rekomandimeve të progres-raportit të BE-së për vitin 2013;

- Të ndërmarrë fushata më të gjera, informuese dhe sensibilizuese, për çështjet e diskriminimit, duke shfrytëzuar të gjitha instrumentet e mundshme, me qëllim ndërgjegjësimin e publikut dhe rritjen e identifikimit të rasteve apo ankesave;

- Monitorim më të thelluar të zbatimit të ligjit për mbrojtjen nga diskriminimi, si në sektorin publik, ashtu edhe në atë privat;

- Kryerjen e sondazheve dhe të studimeve të pavarura dhe bërjen publike të trendit të zhvillimit të diskriminimit, në lidhje me subjekte dhe fusha të ndryshme të diskriminimit, me qëllim parandalimin dhe mbrojtjen kundër fenomeneve të tij;

- Rritjen e aksesit të publikut për adresimin e rasteve të mundshme të diskriminimit, duke thelluar lidhjet e drejtpërdrejta me opinionin publik, për çfarëdo çështjeje që lidhet me diskriminimin;

- Të rrisë transparencën institucionale përmes pasurimit të faqes zyrtare të institucionit, duke pasqyruar të

gjitha vendimet e ankesave të shqyrtuara, informacione të plota dhe të përditësuara, si dhe të mundësojë portale, forume dhe anketime *online*, të aksesueshme për publikun, me qëllim sigurimin e një komunikimi të vlefshëm, në kohë dhe në interes të qytetarëve;

- Të ketë një bashkëpunim më të ngushtë dhe të materializojë bashkëveprimin midis Avokatit të Popullit dhe KMD-së për çështjet e referuara në këto dy institucione;

- Aplikimin e një politike më strikte në përmbushje të sanksioneve administrative, sipas përcaktimeve të ligjit;

- Rritjen e numrit të hetimeve administrative dhe atyre kryesisht;

- Respektimin e afateve ligjore në procesin e hetimit administrativ gjatë shqyrtimit të ankesave.

- Zgjerimit të mbledhjes së të dhënave dhe informimit nga institucionet publike qendrore dhe vendore përgjegjëse sipas ligjit, si dhe ndërhyrjes me veprime konkrete për zbatimin e masave që rrjedhin nga detyrimet ligjore të këtyre institucioneve;

- Intensifikimin e konsultimeve për ndryshimin e ligjit për mbrojtjen nga diskriminimi, si pasojë e pengesave ligjore të konstatuara gjatë zbatimit të tij.

- Angazhim publik të KMD-së në median kombëtare (vizive dhe të shkruar) me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit të qytetarëve lidhur me misionin dhe kompetencat ligjore të KMD-së si institucion, i cili shqyrton çështjet e diskriminimit.

- Vazhdimin e promovimit të praktikave më të mira në këtë fushë, me theks të veçantë në diskriminimin gjinor, grupet vulnerabël, me qëllim sensibilizimin e opinionit publik, lidhur me legjislacionin për mbrojtjen nga diskriminimi.

- Përfshirjen në raport të arsyetimit për mospranimin e ankesave që janë jashtë juridiksionit dhe kompetencës, për efekte studimore dhe informuese, lidhur me nivelin e perceptimit që qytetarët kanë për institucionin.

KRYETARI
Ilir Meta

Miratuar në datën 24.7.2014